



KMDLNJ KRITIKON REAGIMIN E AUTORITETEVE TË KOSOVËS PAS ARRESTIMIT TË TEFIK MUSTAFËS

FAQE 4-5



Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNJ) në Kosovë e ka kritikuar të hënën Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe

të Diasporës së Kosovës (MPJD) për mënyrën e reagimit ndaj arrestimit të shtetasit të Kosovës, Tefik Mustafës, në pikëkalimin kufitar të

Kosovës me Serbinë, Merdar, i cili është arrestuar më 1 qershor nga autoritetet serbe, i dyshuar për "krime lufte"

400 MILIONË SHTETAS TË BE-së VOTOJNË KËTË JAVË PËR PARLAMENTIN EVROPIAN

F. 4



OPOZITA THOTË SE DALLIMET NË MES TË OSMANIT DHE KURTIT JANË TË DUKSHME

F. 5



AKTUALE



PROFESORI AMERIKAN: BIDENI DUHET TË EMËROJË EMISAR SPECIAL PËR NJOHJEN E KOSOVËS NGA PESË VENDET E BE-së

F. 3

ARDITA SINANI SHPALL FITOREN NË PRESHEVË, ARBËR PAJAZITI NË BUJANOC

F. 5

KAMERAT NË VENDVOTIME, KQZ-ja NIS PROCEDURAT E TENDERIMIT

F. 4

EKONOMI



"PSE TË BLEJ KONFLIKT?": PËR HIPOTEKAT QË SHET BANKA S'KA INTERESIM

F. 8

MBAHET FORUMI EKONOMIK KOSOVË - TURQI, KURTI MORI PJESË NË HAPJEN E TIJ

F. 7

SPORT



'DARDANËT' MBAJTËN STËRVITJEN E FUNDIT NË KOSOVË, MURIOI DHE BERISHA PARALAJMËROJNË FITORE

F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjiibiznesi.com
info@kolegjiibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zelensky shkon në Filipine, kërkon mbështetje për samitin e paqes



Kiev, 3 qershor - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, arriti për një vizitë të paparalajmëruar në Filipine, ku pritet të promovojë një samit të paqes, që do të mbahet këtë muaj në Zvicër. Zelensky, i cili mbërriti në Manila nga Singapori, ku mori pjesë në një samit të sigurisë, u takua me presidentin e Filipineve, Ferdinand Marcos. “Ne folëm për Samitin inauguroes Global të Paqes dhe rëndësinë e përfaqësimit të vendeve të Azisë Juglindore atje. Më vjen mirë që Filipinet do të marrin pjesë në samit”, shkroi Zelensky në X. Në takim u diskutua edhe për

bashkëpunimin dypalësh, veçanërisht eksportin e produkteve bujqësore ukrainase në Filipine, tha ai. Një ditë më herët presidenti ukrainas qëndroi në Singapor, ku zhvilloi një sërë takimesh dypalëshe, duke përfshirë me presidentin e Indonezisë, me kongresistë amerikanë dhe me shefin e Pentagonit, Lloyd Austin. Ai, po ashtu, foli në samitin vjetor të mbrojtjes, Shangri-La. Rusia nuk ka marrë pjesë në ngjarjen në Singapor prej se ka nisur pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës dy vjet më parë.

Mbi 50 viktima nga vapa ekstreme në Indi

NEW DELHI, 3 QERSHOR - Më shumë se 50 njerëz vdiqën në Indi gjatë tri ditëve të fundit si pasojë e një vale të të nxehtit që përfshiu disa rajone të këtij vendi. Së paku 33 veta vdiqën në shtetin verior, Utar Pradesh, thanë autoritetet atje. Në mesin e viktimave, sipas tyre, ka edhe njerëz që ishin të angazhuar në zgjedhjet e

përgjithshme, përfshirë zyrtarë dhe roje të sigurisë. Në shtetin Odisha, ndërkaq, humbën jetën së paku 20 njerëz. Ministria federale e Shëndetësisë tha se ka evidentuar së paku 56 vdekje si pasojë e të nxehtit nga 1 marsi deri më 30 maj. India çdo pesë vjet i mban zgjedhjet e saj të përgjithshme në prill dhe maj, por këtë vit

temperaturat ishin rekorde - mbi 45 gradë celsius, e në disa zona edhe 50 gradë. Departamenti i Motit i Indisë tha se temperaturat ka gjasa të bien në ditët në vijim për shkak të fillimit të shirave monsun. Disa rajone janë duke përjetuar, po ashtu, mungesa të mëdha të ujit dhe energjisë elektrike për shkak të rritjes së konsumit gjatë vapës.



Afganistani synon të vaksinojë miliona fëmijë kundër poliomielitit

KABUL, 3 QERSHOR - Afganistani nisi një tjetër fushatë të vaksinimit kundër poliomielitit, e cila synon mbrojtjen e rreth 11.2 milionë fëmijëve nën moshën 5-vjeçare, tha të hënën Ministria e Shëndetësisë e talibanëve. Fushata katërditore mbarëkombëtare - e dyta këtë vit - do t'i mbulojë 34 provincat e vendit, thuhet në deklaratë. “Ne do të bëjmë çdo përpjekje dhe do t'i vazhdojmë fushatat e vaksinimit kundër poliomielitit, ashtu si dhe shërbimet plotësuese shëndetësore, derisa ta zhdukim poliomielitin nga Afganistani”, tha ministri Noor



Jalal Jalali. Ai u bëri thirrje dijetarëve fetarë, pleqve të komunitetit dhe prindërve, që t'i luajnë rolet e tyre

në luftën kundër kësaj sëmundjeje, që mund të çojë në paralizë dhe vdekje. Në dhjetor Organizata Botërore e Shëndetësisë ka paralajmëruar se riatdhesimi i migrantëve afganë nga Pakistani fqinj, e ka rritur rrezikun e përhapjes së poliomielitit. Që atëherë, Afganistani ka kryer disa raunde vaksinimesh. Katër raste të këtij virusi janë regjistruar në Afganistan vetëm këtë vit, sipas Abdul Quddus Baryalait, drejtor i Qendrës Kombëtare për Çrrënjosjen e Poliomielitit. Vitin e kaluar, sipas tij, janë regjistruar gjithsej gjashtë

raste. Fushatat e vaksinimit në Afganistan dhe Pakistan shpesh janë sfiduese për shkak të teorive konspirative se vaksinat e poliomielitit shkaktojnë infertilitet ose se vaksinuesit janë spiunë. Para se ta merrnin pushtetin në gusht të vitit 2021, talibanët kanë ndaluar shkuarjen e vaksinuesve nga shtëpia në shtëpi, në zonat që ata kanë kontrolluar. Megjithatë, Kombet e Bashkuara i kanë bindur ta rinisin programin e vaksinimit në të gjithë vendin pas kthimit të tyre në pushtet.

Meksika zgjedh presidenten e parë grua

Meksiko Siti, 3 qershor - Claudia Sheinbaum u zgjodh presidentja e parë grua e Meksikës. Autoriteti zyrtar zgjedhor i Meksikës tha se rezultatet paraprake tregojnë se Sheinbaum fitoi midis 58 % dhe 60 % të votave në zgjedhjet e së dielës. Rezultati i siguron asaj fitore bindëse kundrejt rivalës Xochitl Galvez, tha autoriteti

zgjedhor. Sheinbaum do ta zëvendësojë mentorin e saj, presidentin në largim, Andres Manuel Lopez Obrador, nisur nga 1 tetori. Ajo premtoi vazhdimësi të politikave të tij, duke thënë se do t'i ndjekë “përparimet” e bëra nga Lopez Obrador. Përpara se të kandidonte për presidente, Sheinbaum, 61 vjeçe, ishte kryetare e Meksiko

Sitit, që është një nga postet më me ndikim politik në këtë vend. Ajo, po ashtu, kishte një karrierë të shkëlqyer si shkencëtare e energjisë përpara se të merrej me politikë. Zgjedhjet, të cilat përballën Sheinbaumin dhe Galvezin, u përshkruan si një ndryshim i madh për të drejtat e grave në Meksikë.



KMDLNj kritikon reagimin e autoriteteve të Kosovës pas arrestimit të Tefik Mustafës

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNJ) në Kosovë e ka kritikuar të hënën Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës së Kosovës (MPJD) për mënyrën e reagimit ndaj arrestimit të shtetasit të Kosovës, Tefik Mustafës, në pikëkalimin kufitar të Kosovës me Serbinë, Merdar, i cili është arrestuar më 1 qershor nga autoritetet serbe, i dyshuar për “krime lufte”

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 3 qershor - Ditë më parë, në pikëkalimin kufitar në Merdar, është arrestuar nga policia serbe Tefik Mehmeti, i dyshuar për krime lufte në vitin 1999. Tefik Mehmeti dyshohet nga autoritetet serbe se më 19 qershor 1999 në autodhën Gjilan - Kamenicë ka ndaluar tre policë serbë, gjithnjë sipas autoriteteve serbe, si ushtar i UÇK-së. E Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut ka reaguar lidhur me këtë. “Rasti i është dorëzuar Prokurorisë për Krime Lufte të Serbisë. Pas arrestimit ishte një reagim kryesisht politik i institucioneve të Kosovës, ndonëse deri tani nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për t’i informuar qytetarët e Kosovës për rrezikun e të kaluarit nëpër Serbi për të gjithë ata që kanë qenë pjesë e luftës, në çfarëdo forme”, thuhet në reagimin e KMDLNj-së, duke theksuar se reagimi i institucioneve ka qenë automatik, si këngë korale, pasi kanë ndodhur arrestimet. “Sidomos për këto dështime dallohet MPJD-ja, që ka përgjegjësi ligjore dhe morale t’i trajtojë me seriozitet këto raste”.

KMDLNj në shumë reagime publike ka kërkuar nga qytetarët që eventualisht mund të arrestohen nga policia serbe për shkak të pjesëmarrjes në luftë apo përkrahjes së saj që mos të udhëtojnë përmes Serbisë aq më parë që kanë shumë mundësi të tjera. “Qytetarët shqiptarë që po arrestohen nuk kanë asnjë mundësi të vizitohen nga organizatat për të drejtat e njeriut, as nga Kosova e as nga Serbia, andaj mungojnë informatat për trajtimin e tyre dhe realizimin e të drejtave të njeriut, si persona të privuar nga liria. Gjithashtu, kanë probleme për sigurimin e një mbrojtjeje efektive ligjore. Në anën tjetër, shtetasit e Serbisë që mbahen në qendrat e paraburgimit dhe ato korrektuese vizitohen pa asnjë pengesë nga autoritetet e Kosovës dhe trajtimi i tyre është 100 % në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare për persona të privuar nga liria”, thuhet në këtë reagim. KMDLNj ka theksuar se duhet të krijohet një mundësi që shtetasit kosovarë që aktualisht janë në burgjet e Serbisë të vizitohen nga monitorues të pavarur sikur që edhe shtetasit e Serbisë që mbahen në burgjet e Kosovës, gjithashtu të vizitohen nga



monitorues të pavarur. “Në të kundërtën gjithmonë do të krijohet një mundësi dhe hapësirë për spekulime nga pozita e përfitimit politik. Serbia po e shfrytëzon arrestimin shtetasve të Kosovës të nacionalitetit serb, të dyshuar për krime lufte për të arrestuar dhe keqtrajtuar shqiptarë të Kosovës që udhëtojnë nëpër Serbi”. KMDLNj-ja u ka bërë thirrje qytetarëve të Kosovës që ta shmangin udhëtimin nëpër Serbi dhe t’i shfrytëzojnë rrugët e tjera sepse Serbia ka mundësi të pakufishme të sajohet prova për kriminalizimin e tyre. “Në

rethanat aktuale, asnjë shqiptar që udhëton nëpër Serbi nuk ka siguri se nuk do të keqtrajtohet, gjohet apo privohet nga liria. Pastaj, ndonëse nuk kanë kryer asnjë vepër penale, duhet të shpenzojnë dhjetëra e dhjetëra mijëra euro për ta rifituar lirinë apo për ta paguar dorëzaninë”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së. Në tri vitet e fundit në Serbi janë arrestuar disa shtetas të Kosovës për, siç është thënë, dyshimet se kanë kryer krime gjatë luftës në Kosovë në periudhën 1998-99. Më 17 prill të këtij viti autoritetet serbe e kanë arrestuar shtetasin tjetër të Kosovës, Sadik Duraku,

me dyshime të njëjta, në njërin prej pikëkalimeve kufitare Kosovë - Serbi. Familjarët e tij i kanë hedhur poshtë akuzat, duke thënë se Duraku ka jetuar në Angli në atë periudhë, bashkë me familjen. Duraku është arrestuar në një vendkalim kufitar në mes të Kroacisë dhe Serbisë dhe një gjykatë serbe ia ka caktuar masën e paraburgimit po atë muaj. Më herët gjatë vitit, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka akuzuar Serbinë për, siç ka thënë ai, arrestime të padrejta, të qëllimshme dhe dashakeqe të qytetarëve të Kosovës.

Profesori amerikan: Bideni duhet të emërojë emisar special për njohjen e Kosovës nga pesë vendet e BE-së

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë, i ndërmjetësuar nga BE-ja, do të merrte drejtim tjetër në rast se Kosova do të njihej nga pesë vendet e Bashkimit Evropian: Spanja, Sllovakia, Rumania, Greqia dhe Qipro. Kështu është shprehur Edward Joseph, profesor në Universitetin “Johns Hopkins” në Uashington, në një raport të fundit. Joseph shprehet se kjo gjë do të kërkojë një përpjekje të vendosur nga administrata e presidentit amerikan Joe Biden në bashkëpunim me aleatët kyçë, për t’i bindur ata që nuk e njohin, për ta ndryshuar qëndrimin e tyre. Ai madje thotë se presidenti i Shteteve të Bashkuara (ShBA), Joe Biden, duhet të emërojë një “emisar special për njohjen e Kosovës” nga pesëshja e Bashkimit Evropian. “Zbatimi i hapave të njëanshëm nga administrata Biden, përfshirë emërimin e një të ‘Dërguari të Posaçëm për Njohjen e Kosovës’,



të shoqëruar me një paralajmërim të qartë amerikan për të sanksionuar çdo

udhëheqës në Shqipëri ose Kosovë që promovon çdo ‘bashkim’ ndërmjet dy vendeve

të pavarura”, thuhet në raportin e fundit të Joseph mbi zhvillimet e fundit në Ballkanin Perëndimor.

Joseph nënvizoi se emisari special për njohjen e Kosovës mund të punojë me ambasadorët e ShBA-së dhe të BE-së në vendet që janë bindur nga Serbia për ta hequr njohjen e Kosovës. “Emërimi i një të dërguari special për njohjen e Kosovës do ta nënvizonte pritshmërinë amerikane për ndryshime të vonuara nga vendet evropiane që nuk e njohin Kosovën”, nënvizoi ai. Ai më tej shton se duke krijuar një rrugë drejt anëtarësimit në NATO për Kosovën, ndikimi që Serbia ka mbi fqinjët e saj dhe mbi ShBA dhe BE do të zhduket. “Në vend të saj, ekuilibri do t’i lejonte Beogradin dhe Prishtinën ta negociojnë zgjidhjen e vetme stabilizuese të mosmarrëveshjes së tyre: njohjen e ndërsjellë bazuar në një Republikë të Kosovës plotësisht sovranë, unitare dhe funksionale, me mbrojtje të plotë për komunitetin serb të Kosovës”, thuhet në raport.



400 milionë shtetas të BE-së votojnë këtë javë për Parlamentin Evropian

BRUKSEL, 3 QERSHOR - Rreth 400 milionë qytetarë të Bashkimit Evropian do të votojnë këtë javë për t'i zgjedhur anëtarët e Parlamentit Evropian, në një nga ngjarjet më të mëdha demokratike globale. Rritja e koston shtesë, pakënaqësitë e fermerëve dhe luftërat në Gazë dhe Ukrainë janë çështjet kryesore në mendjet e votuesve. Të paktën një analiste mendon se rritja e partive të së djathtës së skajshme është e sigurt dhe pyetja kryesore, sipas saj, është sa e madhe do të jetë kjo rritje? Mes 6 dhe 9 qershorit qytetarët e BE-së do të votojnë për anëtarët e Parlamentit Evropian. Ndërsa vazhdojnë luftërat në Lindje të Mesme dhe Ukrainë, çështjet kyçe të fushatës janë mbrojtja dhe siguria. Ekonomia, vendet e punës, varfëria, shëndeti publik, ndryshimet mjedisore dhe e ardhmja e Evropës janë,

gjithashtu, çështje që vlerësohen të rëndësishme për votuesit e BE-së. Një nga pyetjet më të rëndësishme pas zgjedhjeve është nëse presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, do të mbetet në krye si fytyra më e njohur e BE-së. Momentalisht grupi më i madh politik është 'Partia Popullore Evropiane' e qendrës së djathtë, me 176 vende, pasuar nga grupi i Partisë të Socialistëve Evropianë me 139 vende. Pas tyre renditen grupi i liberalëve pro-evropianë me 102 vende dhe grupi i partive të gjelbra dhe atyre rajonale me 72 vende. Dy grupe të së djathtës së skajshme, Konservatorët dhe Reformistët Evropianë (ECR) dhe Identiteti dhe Demokracia (ID), mund të dalin si grupet e treta dhe katërta pas zgjedhjeve. Në Itali, Partia Demokratike shpreson të marrë më shumë

vende se partia Vëllezërit e Italisë të kryeministres Giorgia Meloni. "Këto zgjedhje nuk janë vetëm zgjedhje evropiane. Ato janë zgjedhje me rëndësi për vendin. Partia Demokratike duhet të sigurojë një votë më shumë se Giorgia", thotë Rocco Castelli, mbështetës i Partisë Demokratike të Italisë, raporton Voa. Në Portugali, partia e së djathtës së skajshme 'Chega' e André Venturës, pati rritje të madhe në zgjedhjet që u mbajtën në muajin maj në këtë shtet. Ventura shpreson të përfitojë nga kjo edhe në zgjedhjet e BE-së. Mbështetësit e tij duan kufizime për imigracionin. "Bashkimi Evropian duhet të kuptojë se të kesh një zemër të mirë nuk do të thotë ta mbash derën hapur për çdo person që dëshiron të vijë. Ne kemi traditat tona dhe ato duhen respektuar. Unë i respektoj traditat e të tjerëve. Nëse shkoj në

një vend mysliman, e mbuloj kokën siç kërkohet", thotë Rosa Viegas, mbështetëse e partisë Chega. Maria Demertzis, analiste e Institutit Bruegel, parashikon një rritje të së djathtës. "Çështja është sa e madhe do të jetë kjo rritje?" thotë ajo. "Është e pamundur të mendosh që ndonjë vend i vetëm të jetë në gjendje t'i trajtojë sfidat e mëdha që kemi para, nga ndryshimet klimatike, deri te mbrojtja. Pra, roli i Evropës, në përpjekje për të pasur ndikim, po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm dhe për këtë arsye vendet duhet të kenë kujdes se si po merren këto vendime në Evropë", thotë Demertzis. Zgjedhjet e BE-së mbahen çdo pesë vjet në bllokun 27-anëtarësh. Ky vit shënon zgjedhjet e 10-ta parlamentare që nga zgjedhjet e para më 1979 dhe të parat pas daljes së Britanisë nga BE-ja. Rezultatet e para dalin në

mbrëmjen e 9 qershorit pasi të jenë mbyllur qendrat e votimit në të gjitha vendet anëtare. Vendi i parë që hap qendrat e votimit është Holanda. Numri i deputetëve të zgjedhur në çdo vend varet nga madhësia e popullsisë. Malta, Qipro dhe Luksemburgu kanë nga gjashtë deputetë, ndërsa Gjermania ka numrin më të madh, 96 deputetë. Në vitin 2019 Parlamenti Evropian kishte 751 ligjvënës. Pas largimit të Britanisë nga BE-ja në vitin 2020, numri i eurodeputetëve ra në 705. Disa nga 73 vendet e mbajtura më parë nga eurodeputetët britanikë u rishpërndanë te shtetet e tjera anëtare. Pas këtyre zgjedhjeve, Parlamenti Evropian do të ketë 15 eurodeputetë më shumë, duke e çuar totalin në 720. Dymbëdhjetë vende do të marrin eurodeputetë shtesë.

Kamerat në vendvotime, KQZ-ja nis procedurat e tenderimit

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka njoftuar se është publikuar njoftimi për kontratë për përzgjedhjen e operatorit ekonomik për furnizim me kamera dhe pajisje përcjellëse për regjistrimin e të gjithë aktivitetit gjatë procesit të votimit dhe numërimit në ditën e zgjedhjeve në vendvotime në Republikën e Kosovës. "Afati për dorëzim të

ofertave do të përfundojë më 11 korrik 2024. Të gjitha detajet për këtë procedurë tenderuese janë publikuar në platformën zyrtare E-Prokurimi", thuhet në njoftim. Në përgjithësi, lidhur me përdorimin e kamerave në vendvotime gjatë proceseve të ardhshme zgjedhore, KQZ sqaron qytetarët e Republikës së Kosovës se vendosja e kamerave vëzhguese në hapësirat brenda vendvotimit

bëhet me qëllim të garantimit të sigurisë së materialeve zgjedhore dhe ruajtjes së integritetit të procesit të votimit dhe numërimit në vendvotim. "Vendosja e kamerave në vendvotime do të bëhet duke siguruar plotësisht fshehtësinë e votës, pasi ato do të vendosen në skajin tjetër të vendit ku do të jetë kabina e votimit dhe në asnjë rrethanë nuk do ta mund të regjistrojë shënjin

e preferencës të votuesit. Ruajtja e regjistrimeve të kamerave do të jetë e përkohshme deri në shkatërrimin e materialit zgjedhor, me përjashtim të atyre nga vendvotimet ku evidentohen parregullsi me qëllim që t'u ofrohen institucioneve ligjzbatuese", thuhet në njoftim. KQZ, gjithashtu, thekson se në ditën e zgjedhjeve KQZ nuk do t'i monitorojë këto kamera,



pra regjistrimi nga ana e tyre do të bëhet në mënyrë pasive dhe se qasja në videoregjistrime mund të sigurohet vetëm me vendim apo kërkesë të institucioneve ligjzbatuese.

Ardita Sinani shpall fitoren në Preshevë, Arbër Pajaziti në Bujanoc

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Kandidatja për kryetare të komunës së Preshevës nga radhët e Partisë për Veprim Demokratik, Ardita Sinani, shpalli fitoren në zgjedhjet për pushtetin lokal që u mbajtën të dielën në Serbi.

Në komunën e Preshevës garonin 6 parti politike shqiptare dhe një parti serbe. Sipas rezultateve paraprake, në kuvendin e kësaj komune 37 përfaqësues janë nga radhët e komuniteti shqiptar dhe një nga radhët e komunitetit serb.

Sinani e cilësoi fitoren historike. "Subjekti ynë politik i ka rreth 4 mijë e 78 vota për momentin nga rreth 14 mijë votues që morën pjesë", tha ajo, duke nënvizuar se "ky proces ishte shumë i rëndësishëm për komunën e Preshevës dhe me maturi dhe këmbë në tokë duhet të qeverisim për katër vitet e ardhshme. Qytetarët e Preshevës kanë treguar maturi politike. Procesi ka shkuar

mbarë dhe gjithçka deri tash ka përfunduar në mënyrën më të mirë të mundshme", ka thënë ajo.

Sinani kishte shërbyer edhe më herët kryetare e komunës së Preshevës, ndërsa së voni shërbeu këshilltare politike e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, për rajonin e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit.

Në komunën e Bujanocit, po ashtu, komunë me shumicë shqiptare në jug të Serbisë, fitoren e shpalli Arbër Pajaziti nga lista zgjedhore Fronti për Ndryshim.

Përfaqësuesit e shqiptarëve thonë se vështirësitë me të cilat përballet rajoni, që nga mungesa e investimeve ekonomike e deri te mosnjohja e diplomave, posaçërisht procesi i "pasivizimit" të adresave të shqiptarëve, kanë ndikuar në ekuilibrin etnik dhe, rrjedhimisht, përfaqësimin politik të shqiptarëve nga ky rajon.



Opozita thotë se dallimet në mes të Osmanit dhe Kurtit janë të dukshme

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Opozita në vend e sheh si shpërfaqje të dallimeve që gjithmonë kanë ekzistuar, përplasjen ndërmjet presidentes Vjosa Osmani dhe qeverisë, pasi kjo e fundit nuk e kontaktoi fare Osmanin kur dërgoi letrën në Asambleen e Këshillit të Evropës. Sipas opozitës, këto dallime tregojnë që ka probleme serioze të funksionimit të shtetit. Dallimet ndërmjet presidentes Vjosa Osmani dhe qeverisë opozita i sheh si shpërfaqje të dallimeve që këto institucione kanë ndërmjet vete.

Lutfi Haziri nga Lidhja Demokratike e Kosovës, në një prononcim për Radio Kosovën, ka thënë se për të janë të



habitshme dallimet ndërmjet presidentes dhe ministrisë së Jashtme pasi, siç thotë ai, kompetencat e politikës së Jashtme bien te Presidenca.

Haziri ka thënë se mosdakordimi institucional tregon që shteti ka probleme serioze. "Ka qenë obligim që Kuvendi dhe qeveria të

koordinohen në mënyrë që letra e zotimeve që presidentja, kryeparlamentari dhe kryeministri e kanë bërë, të jetë një letër më e fuqishme si garanci, si siguri që kanë për t'i zbatuar obligimet, por ndodhi e kundërta. Kjo tregon qartë se ka probleme serioze në kuptim të funksionimit të shtetit dhe shumica prej tyre e kanë Republikën e Kosovës të përkohshme, fatkeqësisht", ka deklaruar Haziri.

Sipas deputetes së Aleancës për Ardhmërisë së Kosovës, Time Kadrijaj, deri më tani presidentja ka qenë e heshtur edhe përballë gabimeve që, sipas saj, i ka bërë kryeministri Albin Kurti, ndërsa ka thënë se

reagimet e saj të fundit janë të befasishme. "Edhe pse kryeministri Kurti ka bërë gabime të njëpasnjëshme, është dashur presidentja t'i evidentojë ato të bëma të kryeministrit. Megjithatë, ka qëndruar e heshtur dhe tani befasisht po del që po e kundërshton. Do të thotë, u shpërfaqen dallimet ndërmjet Presidencës dhe Qeverisë", ka deklaruar Kadrijaj.

Radio Kosova ka tentuar të marrë edhe opinionin të Partisë Demokratike të Kosovës për sa iu përket përplasjeve ndërmjet presidentes Vjosa Osmani dhe qeverisë, mirëpo PDK-ja nuk ka dashur të deklarohet për këtë çështje.

Rohde: Gjermania e përkushtuar për ta futur Kosovën në KiE, ecja përpara me Asociacionin do ta mundësojë këtë

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Ambasadori i Gjermanisë, Jorn Rohde, ka folur për forcimin e sundimit të ligjit dhe përgatitjet e Kosovës për t'u anëtarësuar në Këshillin e Evropës, por ka theksuar se kjo nuk do të ndodhë pa ecur përpara me Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe.

Pas një takimi me përfaqësues

të organizatave joqeveritare IKD dhe FOL me të cilët tha se foli për përmirësimin e qasjes në drejtësi në përpunje me standardet e KiE, Rohde tha se Gjermania mbetet e përkushtuar për ta anëtarësuar Kosovën në KiE sa më parë. "Për ta forcuar sundimin e ligjit dhe për t'u përgatitur Kosova për Këshillin e Evropës ne do ta

mbështesim projektin e përbashkët të Institutit të Kosovës për Drejtësi/FOL për ta përmirësuar qasjen në drejtësi në përpunje me standardet e KiE. Gjermania mbetet e përkushtuar për ta futur Kosovën në Këshill sa më shpejt. Ecja përpara me Asociacionin do ta bëjë këtë të ndodhë", ka shkruar Rohde në "X".



Shtrohet me zhavorr rruga e blegtorit më të madh në komunën e Podujevës

PODUJEVË, 3 QERSHOR - Drejtori i Shërbimeve Publike në Podujevë, Bahri Selimi, ka vizituar fshatin Metergoc, aty ku rruga "Jahë Bilalli" është shtruar me zhavorr, janë vendosur gypat atmosferikë dhe janë hapur kanalet anësore të rrugës. Blegtori Osman Bilalli, i cili

jeton në këtë rrugë, mban mbi 120 krerë lopë. Ai i shprehu mirënjohje komunës për realizimin e këtij projekti që lehtëson punën e tij. Fermeri Bilalli thotë se për shkak të rrugës që deri tash ishte e pakalueshme, ishte detyruar ta humbte

qumështin, sepse grumbulluesit e qumështit e kishin të vështirë qasjen te ferma e tij. Në këtë rrugë me gjatësi mbi 1.5 km janë edhe dy bletarë. Krahas kësaj rruge, me zhavorr tash është duke u punuar edhe në rrugën lidhëse Orllan - Bllatë me gjatësi 4.2 km.



Mbahet mbledhje përkujtimore për Agim Vatovcin

VUSHTRRI, 3 QERSHOR - Ish-kryetari i Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara dhe avokuesi për të drejtat e njeriut, Agim Vatovci, ka vdekur në moshën 68-vjeçare. Të hënën është mbajtur mbledhje përkujtimore në nderim të jetës dhe veprës së ish-kryetarit të Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara dhe avokuesit për të drejtat e njeriut, Agim Vatovci. Kontributi që Agim Vatovci ka dhënë për avancimin e të drejtave të njeriut, në veçanti për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, u vlerësua lart nga të pranishmit në këtë mbledhje përkujtimore.

Kryetari i komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi, në përkujdesjen e të cilit u organizua mbledhja përkujtimore, tha se emri i Agim Vatovcit nuk do të harrohet asnjëherë. "Qyteti i Vushtrrisë humbi një aktivist të pasqor që gjithë jetën u angazhua për avancimin e të drejtave të njeriut, në veçanti për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Puna e tij do të bëjë që emri i tij të përmendet gjithëherë me krenari", tha kryetari Idrizi.

Agim Vatovci ka qenë kryetar i Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara dhe avokues për të drejtat e njeriut.



Nderimi për komandantin e UÇK-së, Zenën, do të jetë i përhershëm

DRENAS, 3 QERSHOR - Në Sallën e Kulturës, në përkujdesjen e kryetarit të komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, është mbajtur mbledhje përkujtimore për nder të jetës dhe veprës së ish-komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Brigadën 114, Zejnullah Prokshi.

Ne këtë mbledhje morën pjesë kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, me staf, struktura komunale nga Skenderaj, ish-luftëtarë të Zenës, shoqatat e dala nga lufta nga niveli qendror dhe lokal, veteranë dhe invalidë të UÇK-së, familjarë dhe shumë qytetarë. "Sot, me mbledhje komemorativë, i dhëmë lamtumirën e fundit ish-komandantit të UÇK-së, Zejnullah



Prokshit, me familjarë e miq të tij, me drejtues lokalë e qendrorë të komunës së Drenasit, Skenderajt, shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së dhe qytetarë të shumtë. Shpreha nderim për jetën dhe veprën e tij atdhetare, duke veçuar dy momente të pashlyeshme. I pari,

kur erdhi i plagosur në Tiranë. I dyti, kur hyri në operacion në Turqi. Nderimi për Zenën do të jetë i përhershëm për veprën e tij atdhetare, angazhimit në kuadër të UÇK-së, më pastaj në TMK dhe FSK", ka thënë kryetari Lladrovci në këtë mbledhje.

Heroi Skender Rexhepi, komandant "Hekuri", ka vetëm ditëlindje

RAHOVEC, 3 QERSHOR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, në ditëlindjen e 59, në fshatin Mrasor, ka vizituar shtëpinë-muze të heroit të kombit Skënder Rexhepi - komandant "Hekuri".

Latifi ka thënë se komandant "Hekuri" do të kujtohet për trimërinë e paepur dhe për rezistencën e lavdishme kundër pushtuesve serbë deri në ditën e tij të fundit, kur ra me pushkë në dorë, në një pritë armike, më 21 janar 1999, në një kodër mbi fshatin Fortesë. "Skënderi do të mbetet një prej shembujve më frymëzues për atdhedashuri, sepse i shërbeu atdheut dhe ia fali jetën e tij, pas një veprimtarie të gjatë e të



bujshme të angazhimit për zgjidhjen e çështjes kombëtare. Kjo shtëpi-muze pasqyron të kaluarën tonë të lavdishme. Prandaj, ne do të vazhdojmë t'i trajtojmë dhe t'i restaurojmë shtëpitë si kjo, me qëllim të ruajtjes së vlerave të UÇK-së dhe të vlerave tona kombëtare. Lavdi emrit dhe veprës së pavdekshme të heroit Skënder Rexhepi!", ka shkruar Latifi në "Facebook".

Po vazhdon ndërtimi i Qendrës për Arte, Kulturë dhe Inovacion në Rahovec

RAHOVEC, 3 QERSHOR - Me ritëm të shpejtë janë duke vazhduar punimet në ndërtimin e Qendrës për Arte, Kulturë dhe Inovacion në Rahovec.

Ndërtimi i kësaj qendre kap vlerën afër tre milionë euro dhe ka një sipërfaqe të tërësishme mbi 6 mijë e 200

m2, me hapësira të ndryshme si sallën universale, me një auditor me rreth 400 ulëse, shkollën e muzikës, studio për kërcim, klasën për balet. Pjesë e objektit do të jetë edhe Qendra për Inovacion dhe Teknologji, e cila ka të inkuadruar brenda

laboratorin, dhomat për punëtori të ndryshme, sallën për takime dhe trajnime. Po ashtu, është e paraparë edhe biblioteka, ku përfshihen sallat për lexim grupor dhe individual, ekspozim të librit, nototekën dhe sallën për kompjuterë.



Mbahet Forumi Ekonomik Kosovë - Turqi, Kurti mori pjesë në hapjen e tij

“Lidhjet tona janë vendosur në një trajektore gjithnjë e në rritje të bashkëpunimit ekonomik, me investimet turke të gatshme për të luajtur një rol jetik në zhvillimin e Kosovës. Fushat kryesore të bashkëpunimit përfshijnë tregtinë, mbrojtjen, teknologjinë dhe industrinë e lehtë”, ka thënë kryeministri Albin Kurti

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

STAMBOLL, 3 QERSHOR - Për herë të parë po mbahet Forumi Ekonomik në mes të Kosovës dhe Turqisë i cili po zhvillohet në Stamboll. Ky forum mbledh bashkëbiznese nga Kosova dhe Turqia me qëllim të forcimit të bashkëpunimit dhe zgjerimit të mundësive për investime. Fillimit të ngjarjes i parapriu një takim bilateral në mes të kryeministrit të Republikës së Kosovës, Albin Kurti dhe Ministrit të Tregtisë të Turqisë, Ömer Bolat.

Në fjalën e tij në hapje të forumit, kryeministri shprehu mirënjohjen për marrëdhëniet e thella ndërmjet Kosovës dhe Turqisë, duke nënvizuar dhe rolin që do të ketë ky forum në avancimin e mëtejshëm të bashkëpunimit mes dy vendeve tona. “Lidhjet tona janë vendosur në një trajektore gjithnjë e në rritje të bashkëpunimit ekonomik, me investimet turke të

gatshme për të luajtur një rol jetik në zhvillimin e Kosovës. Fushat kryesore të bashkëpunimit përfshijnë tregtinë, mbrojtjen, teknologjinë dhe industrinë e lehtë. Këtu me ne sot janë dhjetëra kompani të suksesshme nga Kosova si dhe përfaqësues të Odës Tregtare Kosovaro-Turke, Shoqatës së Përpunimit të Drurit në Kosovë dhe Shoqatës së Përpunuesve të Pemëve dhe Perimeve, duke demonstruar potencialin dhe perspektivat investuese që ofron Kosova për investitorët turq”, tha kryeministri.

Më tej ai trajtoi zhvillimin e progresin që ka njohur vendi në tri vitet e fundit, e ku në vijim u fokusua në përmirësimin e ambientit të të bërit biznes dhe zhvillimin proaktiv të tri grupeve të sektorit privat: agrikulturë, industrinë dhe sektor të teknologjisë. “Kosova krenohet me ekonominë demokratike, të sigurt, të qëndrueshme dhe me treg të hapur, të mbështetur nga



partneritetet me Bashkimin Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermaninë, Britaninë e Madhe, Francën, Italinë dhe shumë vende të tjera anëmbanë botës. E njohur për përparimet e saj në sundimin e ligjit, të drejtat politike, liritë civile dhe demokracinë zgjedhore, Kosova është njohur si vendi më demokratik në Ballkan. Prandaj, Kosova paraqet një destinacion

ideal për bizneset turke që kërkojnë t'i rindërtojnë njësitë e tyre prodhuese në një vend të orientuar kah vlerat demokratike dhe stabiliteti ekonomik”, përfundoi kryeministri.

Pas fjalës së kryeministrit forumi vijoi me dy panele të diskutimit. Njëri mbi mundësitë e investimeve në infrastrukturë, ku si panelistë ishin zëvendësministri i Mjedisit,

Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Hysen Durmishi, zëvendësministri i Ekonomisë, Getoar Mjeku, dhe zëvendësministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Daulina Osmani. Ndërkaq, paneli i dytë, i përbërë nga ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, zëvendësministri i Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë, Mentor Arifaj.

Mision humanitar në QKUK, operohen fëmijë me probleme në zemër



EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, Elvir Azizi dhe ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Jonathan Hargreaves, kanë mirëpritur të hënën në QKUK ekipin e mjekëve kardiokirurgë dhe kardiologë të fëmijëve nga Turqia në kuadër të misionit “Muntada Aid”.

Të pranishëm ishin edhe këshilltarja e kryeministrit të Kosovës, Elizabeth Goëing, dr. Ramush Bejiqi, drejtoresha e Klinikës së Pediatriisë, dr. Violeta

Grajqevci, drejtoresha e Klinikës së Radiologjisë Shkëndije Nuza dhe dr. Shpejtim Shurdhiqi, u. d. drejtor i Klinikës së Kardiokirurgjisë.

Ekipi i mjekëve nga Turqia do të realizojë intervenime kardiokirurgjike te fëmijët me probleme në zemër dhe do të bëjë ekzaminime kardiologjike.

Drejtori i ShSKUK-së, Elvir Azizi, falënderoi organizatën “Muntada Aid” dhe ambasadorin Hargreaves për mbështetjen, duke shtuar se ky mision është një mundësi e mirë që fëmijët e Kosovës të përfitojnë intervenime në zemër, pa pasur nevojë të dalin jashtë vendit.

Ambasadori i Britanisë së Madhe, Jonathan Hargreaves, u shpreh i lumtur që ky mision humanitar po realizohet dhe që po përfitojnë fëmijët e Kosovës.

Në emër të ekipit foli dr. Ibrahim Cansaran, i cili, po ashtu, shprehu kënaqësinë që kanë mundësinë t'i ndihmojnë fëmijët e Kosovës. Sipas tij, kjo është një mundësi e mirë që të përfitojë përvojë edhe stafi i mjekëve dhe infermierëve.

Në përbërje të ekipit mjekësor ka mjekë kardiologë, kardiokirurgë, anesteziologë, infermierë dhe teknikë të anestezionit. Misioni ka filluar ditën e sotme dhe do të zgjasë 10 ditë.

Fillon testimi mjekësor dhe psikologjik periodik i 275 pjesëtarëve të Njësisë Speciale

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Ka filluar testimi mjekësor dhe psikologjik periodik i 275 pjesëtarëve të Njësisë të Specializuar të Policisë së Kosovës. Testimet po kryhen në tërë Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës.

Drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, Elvir Azizi dhe drejtoresha e Drejtorisë së Shërbimeve Shëndetësore në Policinë e Kosovës, dr. Lindita Kajtazi, kanë parë nga afër punën që po bëhet nga stafi mjekësor për t'i kryer ekzaminimet e këtyre

pjesëtarëve të policisë. ShSKUK-ja më herët ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Policinë e Kosovës për të ofruar kontrolle sistematike të policëve të Kosovës dhe, po ashtu, kontrolle për rekrutët rinj të Policisë së Kosovës.



“Pse të blej konflikt?”: Për hipotekat që shet banka s’ka interesim



PRISHTINË, 3 QERSHOR - Pothuajse të gjitha bankat komerciale që veprojnë në Kosovë kanë në shitje prona të cilat janë lënë hipotekë nga huamarrësit që s’i kanë shlyer kreditë. Pavarësisht prej çmimeve më të lira se në treg, interesi i blerësve për to mungon - mesa duket për shkak të perceptimeve kulturore që lidhen me blerjen e pronave të poseduara. Banka Qendrore e Kosovës raporton për rritje të lehtë të kredive problematike. Ekspertët, në anën tjetër, sugjerojnë masa legislative për lehtësimin e shitjes së pronave të tilla.

Shtëpi, toka, objekte biznesi...

Një shtëpi në fshatin Komoran të komunës së Drenasit, me rreth 1.000 m², ofrohet në shitje nga një bankë komerciale në Kosovë. Një tjetër bankë shet 20 ar tokë në Graçanicë, bashkë me shtëpi prej 220 m² dhe një objekt biznesi. Oferta të ngjashme ka pothuajse në të 11 bankat komerciale që operojnë në Kosovë, por shumë pak prej tyre i kanë publike çmimet.

Radio Evropa e Lirë kontaktoi disa nga to - Raiffeisen Bank, Procredit Bank, Teb Bank, Banka Kombëtare Tregtare, NLB, Banka Ekonomike e Kosovës - për t’i pyetur se sa kushtojnë, por nuk mori përgjigje prej asnjërës.

Oferta e lartpërmendur në Graçanicë e ka publik çmimin prej 182 mijë eurosh.

Radio Evropa e Lirë bisedoi me përfaqësuesin e një agjencie të patundshmërive në Kosovë, i cili tha se një ar tokë në këtë komunë sillet nga 10 mijë deri në 45 mijë euro, varësisht lokacionit.

Sipas tij, çmimet e të gjitha pronave që shiten nga bankat janë më të lira se ato në treg, por ai nuk ofroi ndonjë përqindje specifike.

Bankat e kontaktuara nga REL-i nuk treguan as a ka interesim për blerjen e hipotekave në shitje, por nga përgjigjet e disa qytetarëve të anketuar në Prishtinë, duket se jo. “Nuk mund të blej prona të tilla, pasi nuk di se në çfarë vështirësish financiare ka kaluar ish-pronari”, thotë Arsimi. “Edhe unë e kam hipotekë banesën ku jetoj. Paramendoni sikur të më paraqitet ndonjë vështirësi rrugës dhe të mos arrij ta kthej kredinë dhe të ma marrë banka

dhe ta shesë... Jo, unë nuk mund ta blej edhe sikur të ma falnin”, thotë ai.

Besnik Ajvazi, punonjës në sektorin publik, e konsideron “blerje të konfliktit” investimin në pronat e tilla.

“Pse duhet blerë konflikti? Mund të vijë pronari dhe të më sjellë probleme”, thotë ai.

Çka janë kreditë problematike dhe sa është vlera e tyre?

Vlera e kredive në bankat komerciale të Kosovës ka arritur në 5.1 miliardë euro deri në prill të këtij viti, sipas Bankës Qendrore të Kosovës.

Kredi problematike konsiderohen ato që kredimarrësi nuk arrin t’i paguajë sipas marrëveshjes.

Ato përbëjnë 2.1 për qind të vlerës së përgjithshme të kredive, sipas BQK-së. Në prill të vitit të kaluar, kjo shifër ishte 2 për qind. BQK-ja nuk iu përgjigj pyetjes së REL-it se ku janë të përqendruara kreditë problematike - te bizneset apo individët.

Nëse ato llogariten në euro, sipas profesorit të Ekonomisë në

Universitetin e Prishtinës, Mejdi Bektashi, bëhet fjalë për më shumë se 100 milionë. “Çdo ditë kemi ankande të shumta, ku bankat i qesin në shitje pronat e lëna hipotekë të kredimarrëseve, me qëllim që të rimbursohet kredia e marrë më herët”, thotë për Radion Evropa e Lirë Bektashi, i cili më herët ka shërbyer si anëtar i Bordit të BQK-së. Për këto prona, sipas tij, nuk ka pasur asnjëherë interesim. “Jo vetëm në Kosovë, por në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor e kemi një mentalitet, sipas të cilit, blerja e këtyre pronave konsiderohet shkelje e dinjitetit të njerëzve. Dhe, për shkak të ngatërresave eventuale, pjesa më e madhe e tyre nuk shiten... sepse askush nuk dëshiron të futet në mosmarrëveshje me ish-pronarin e asaj pasurie”, thotë Bektashi.

Si mund të zgjidhet çështja?

Marrë parasysh hezitimin e qytetarëve për t’i blerë këto prona nga bankat, ish-guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, thotë se kjo çështje duhet të rregullohet me

një ligj të veçantë. “Le t’i blejë shteti asetet e bankave dhe të bëhet pronar, e pastaj t’i shesë. Kur shteti i shet, qytetarët nuk hezitojnë t’i blejnë”, shprehet ai. Se cilat janë mundësitë që kjo çështje të rregullohet në këtë mënyrë, REL-it nuk iu përgjigj as Zyra e Kryeministrit të Kosovës, as Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Bektashi dhe Mehmeti vlerësojnë se rreziku nga kreditë problematike bën që bankat, gjatë procedurave për marrje të kredive, ta zhvlerësojnë vlerën e patundshmërive të lëna hipotekë dhe të aplikojnë kritere të vështira për aprovimin e kredive. Norma e interesit për kredi sillet rreth 6.1 për qind.

Në një raport që ka publikuar BQK-ja vitin e kaluar, thuhet se vlera e kredive problematike ka nisur të rritet nga fillimi i vitit 2022 për të vazhduar deri në shtator të vitit 2023.

Po atëkohë, në Kosovë ka nisur të rritet edhe vlera e inflacionit. Viti 2022 është mbyllur me normë mesatare inflacioni rreth 12 për qind.

Paga mesatare në vend, sipas Agjencisë së Statistikave, është 521 euro, ndërsa shkalla e papunësisë pak mbi 10 për qind.

Shoqëria në dilemë: Teknofobi apo teknoprofeci?

Nga: Gëzim TUSHI

Fenomeni i internetit masiv dhe rrjeteve sociale në zgjerim ka sjellë shumë pasoja pozitive dhe negative në shoqërinë tonë. Nëse nga ana formale e dukjes statistikore për komunikimin virtual rezultatet janë pozitive, në anën thelbësore ndodh shpesh që përballemi me një dukuri të re sociale. Njerëz me pikëpamje të ngjashme nën ndikimin egalitar dhe “bombardimin informativ” nga interneti me rrjetet sociale, duket sikur përfundojnë në “situatë bosh”. Sepse, interneti ka aftësinë t’i vendosë njerëzit në komunikim nëpërmjet një “dhome jehone” të vogël, duke krijuar konturet e dëmshme të një “shoqërie të vogël sociale”, por me dimensione të zgjeruara dixhitale. Tashmë është fare evident ndikimi i internetit në procesin e “egalitarizmit” të ideve, qëndrimeve dhe mënyrave të sjelljes në shoqërinë tonë. Ndikimi pozitiv dhe negativ në të njëjtën kohë, konsiderohet nga sociologët si një problem social urgjent, sepse ka efekte të gjëra dhe “po ndryshon demokracinë tonë, po ndryshon aftësinë tonë për të bërë një bisedë të vërtetë apo për të pasur një marrëdhënie të sinqertë me njëritjetrin” – thotë Tritan Harris, një punonjës me influencë i Google-it.

Ne duhet të bëhemi më sensibil dhe të kuptojmë më mirë realitetet dhe, mbi të gjitha, ndikimin pa rregulla të informacionit të shpejtë, të njëtrajtshëm në publikun shqiptar, që në shumë raste është faktori që sjell shkulme të njëjta, të njëtrajtshme në kohë, të barabarta në sasi, të njëjta në cilësi. Kjo situatë është ndikuese në rrafshimin e nivelit dhe barazitarizmit të informacionit, duke ndikuar në shfaqjen tek njerëzit të një fenomeni të ri, të cilin sociologët e quajnë si shfaqje masive të “publikut egalitar”. Një produkt evident i “revolucionit dixhital” dhe zgjerimit të rrjeteve sociale, që është ekzistent edhe në shoqërinë tonë. Një proces që njerëzit i bën në të njëjtën kohë të jenë “shkrues” dhe “lexues” të lajmeve dhe informacioneve që prodhojnë “fabrikat” e politikës, jetës sociale, shpifjeve dhe thashethemeve banale.

Një nga gjërat pozitive është padyshim karakteri demokratik e masiv i kanaleve të komunikimit social e lidhjeve interpersonale, që padyshim në shoqërinë tonë ka sjellë një realitet të ri, përmasa të gjëra të demokratizimit të skajshëm të komunikimit. Janë të shumtë komponentët e interferuar e të integruar që ka sjellë interneti dhe rrjetet sociale. Por, personalisht gjykoj se mbi të gjitha tashmë është krijuar një dukuri e re, me përmasa të plota sociale, që ka sjellë krijimin e një lloj barazie informative dhe strukturën sociale të “publikut egalitar”.

Dukuri që është më e fortë në dukje se sa në thelbin e vet, duke krijuar dikotominë midis të vërtetës dhe iluzionit të krijimit të një shoqërie që përjeton “informacion të demokratizuar”, në të cilën njerëzit kanë mundësi të barabarta në lidhjen, komunikimin, përdorimin e personalizuar të informacionit. Është e vërtetë që sot në Shqipëri kemi një realitet të ri komunikativ, në të cilin ekziston një “hapësirë virtuale e barabartë”, ku nxënësi e studenti, qytetari metropolitani dhe banori rural, intelektual dhe i papuni, pensionistët dhe të rinjtë, burrat dhe gratë janë me të drejta të barabarta në këtë konsum të informacionit elektronik të demokratizuar dhe të “egalitarizuar”. Qoftë politik, kulturor, global, rajonal apo nacional, i vërtetë apo i gënjeshtërt. Një rrjet që tashmë në shoqërinë shqiptare, është një realitet socio-komunikativ që ka prekur të gjithë sferat e jetës duke përfshirë politikën, ekonominë, arsimin, shkencën, kulturën, shëndetësinë, ushtrinë etj. Në pikëpamje sociale, kjo teknologji ka sjellë pasoja në strukturën e lidhjeve sociale, tipologjinë e marrëdhënieve të shoqërizimit human. Sepse, njerëzit janë sot më shumë të lidhur, presin më shumë impakt nga teknologjia, potencia e saj komunikative virtuale, se sa nga lidhjet reale e të personalizuara me njëri tjetrin. Sociologët mendojnë se diskutimet për raportet e njeriut dhe shoqërisë, me internetin dhe komunikimin dixhital, duhen vlerësuar në mënyrë sintetike, sepse ndikimet e tij janë gjithëpërfshirëse dhe ndikojnë në ndryshimin e strukturës së jetës dhe cilësinë e demokracisë.

Mbi të gjithë, ky realitet dixhital dhe elektronik po ndryshon aftësinë e njerëzve individualisht, kapacitetet e tyre për të bërë një bisedë të vërtetë, për të pasur marrëdhënie të sinqerta me njëritjetrin. Padyshim “egalitalizmi informativ” është një dukuri e postmodernitetit, tërësisht e lidhur me teknologjinë dixhitale dhe fuqinë rrafshuese të rrjeteve sociale. Kjo ka bërë, që në jetën e sotme është e vështirë të shikosh se cilat janë problemet e tua, në kushtet kur edhe të tjerët shfaqin në rrjetet sociale të njëjtat probleme. Sepse në të vërtetë ndërsa në dukje është krijuar përshtypja se marrëdhëniet midis njerëzve nëpërmjet lidhjeve virtuale duket sikur po forcohen, në fakt është e padiskutueshme që lidhjet e vërteta empirike e sociale midis njerëzve janë duke u “copëtuar”. Madje, deri në nivele të skajshme të shfaqjes në mënyrë masive të “njeriut mbi individualist”, asocial, të vetmuar, i bindur për të qenë i vetëmjaftueshëm në raportet dhe lidhjet e personalizuara. Realisht dhe virtualisht.

Ne nuk kemi statistika sesa është përqindja e popullsisë shqiptare që



ka lidhje me internetin, apo se sa herë në ditë, javë e muaj njerëzit tanë përdorin Facebook-un. Por me siguri që është në rritje masa sociale e njerëzve që kanë mundur, përmes telefonave celularë (smartfonëve) të kenë akses të zgjeruar në internet. Kjo ka krijuar një gjendje, për të cilën kohë më parë Eric Schmid, ish-shëf (CEO) i Google-it, theksoi se “interneti është gjëja e parë që njerëzimi ka ndërtuar dhe që nuk arrin të kuptojë si funksionon, eksperimenti më i madh anarkik që kemi bërë ndonjëherë”.

Zhvillimi teknologjisë, përdorimi zgjeruar i rrjeteve sociale, celularëve inteligjentë në mënyrë kaq të zgjeruar, me intensitet në rritje, është një nga treguesit sintetikë të faktit që shoqëria jonë është përfshirë integralisht nga sfidat, shqetësimet, dukuritë më komplekse të jetës postmoderne, të lidhur dhe interferuar me teknologjinë dixhitale. Ndërkaq, për shkak të niveleve të ndryshme të arsimit dhe kualifikimit, struktura sociale e “publikut informativisht egalitar” nuk është e barabartë. Sepse raporti i qytetarëve për shkak të shumë faktorëve materialë e kulturorë, konceptualisht dhe materialisht nuk është i njëjtë me këto zhvillime të informacionit, rrjetëzimit dhe mediatizimit.

Kjo situatë sociologjiskisht kaotike e bën imperative nevojën e shpjegimit dhe konceptimit të drejtë të lidhjeve të njeriut me teknologjinë, internetin dhe rrjetet sociale, duke evidentuar anën pozitive, si faktor me rëndësi në përsheptimin e lidhjeve dhe komunikimit social, por dhe si shkak për shfaqjen e shumë negacioneve, patologjive me dimension të gjerë social.

Problemet e raporteve të shoqërisë dhe individit me internetin dhe rrjetet sociale mbeten në qendër të vëmendjes së jetës së shoqërisë. Të gjithë sociologët dhe psikologët kanë arritur në një përfundim që kjo situatë duhet vlerësuar seriozisht, sepse “rrjetet sociale janë ndër problematikat tona më të mëdha”, sepse ka sjellë shumë probleme dhe shqetësime sociale.

Madje, deri në nivelin e rrezikut social, që në lidhjet dhe marrëdhëniet tona jo vetëm të “mos i zëmë besë njëri-tjetrit”, por edhe të kemi vështirësi për të “punuar bashkë” me njëri-tjetrin. Interneti ka sjellë ndryshime konceptuale në shoqërinë shqiptare dhe jetën e përditshme komunikative të njeriut, i cili ka filluar ta kuptojë, ndjejë dhe realizojë ndryshe “rolin”, jo vetëm këtu në vendin tonë, por edhe si “lojtar universal” dhe aktor pjesëmarrës në këtë dramë të madhe të historisë globale. Shumica absolute e shqiptarëve e kanë kuptuar dhe janë ndërgjegjësuar me faktin, se sasia e ngjarjeve dhe densiteti i pandërprerë i informacioneve, kanë krijuar një raport të ri me kohën, shoqërinë dhe perceptimet vetjake.



Sepse, jetojmë në kohëra të reja, kur “nga të gjitha ndryshimet e shpejta në jetën moderne, asgjë nuk krahasohet me evolucionin e shpejtë në teknologji dhe mënyrën se si e përdorim atë për ta argëtuar veten, për të komunikuar dhe për të influencuar të tjerët – dhe mënyrën se si na ndikojnë të tjerët përmes asaj që na vjen përmes televizioneve tona, kompjuterëve, ekraneve të smartfonëve dhe medive të tjera” (Eliot Aronson, Joshua Aronson, “Kafsha sociale” f. 139), Padyshim, teknologjia e informacionit u ka dhënë një formë të caktuar postmoderne zhvillimeve në qytetërimin tonë, sepse ajo është bërë tashmë “frymë e kohës” ose akoma më qartë, “filozofi kolektive e jetës”, në kuptimin që ka përfshirë të gjitha strukturat e jetës intime, private, kulturore, kolektive e globale. Sikurse shkruan Margartet Archer, jetojmë në një “shoqëri informative”, e cila po sjell rikonceptualizimin e çështjes, se çfarë do të thotë të jesh njeri në këtë kohë, në kushtet kur e gjithë kultura i nënshtrohet teknologjisë informative, kurse racionaliteti instrumental bëhet bazik, dhe për pasojë mbizotëron “imperializmi i arsyes instrumentale”, që është tipik për sjelljen e njeriut

postmodern që jeton intensivisht në mënyrë të pashmangshme, madje të detyruar në konturet determinante të “shoqërisë së informacionit, rrjetëzimit ... dhe komunikimit të përsheptuar”.

Në këtë kontekst duhen parë të dyja anët e ndikimit të ndikimit kontradiktor të internetit dhe komunikimit virtual, i cili paradoksalisht sjell pasoja, që në dukje janë me ndikime të kundërta te publiku i gjerë. Kjo gjendje sociale, raportet e reja të njeriut me teknologjinë e informacionit ka sjellë disa të mira, që jo vetëm duken, por kemi filluar t’i “shijojmë”, sikurse janë humbja e kontrollit dhe censurës së informacionit, mundësitë e leximit dhe komunikimit të lirë midis njerëzve. Komunikimi përmes kanaleve mediatike apo rrjetit dixhital, ka mundësi që nëpërmjet transmetimit të një informacioni të gjerë, në përmasa të mëdha në të njëjtën kohë të sjell një proces social që shfaqet në formën e “unifikimit” të opinionit publik për çështje të caktuara që shqetësojnë qytetarin, politikën apo shoqërinë shqiptare.

Nga ana tjetër, është plotësisht e besueshme, shfaqja e zgjeruar e një lloji ndikimi social “fragmentues” i strukturës së opinionit, për shkak të larmisë virtuale të këndshikimit të fakteve ngjarjeve apo interpretimit të diversifikuar të tyre, si rezultat i larmisë dhe peshës sociale të hermeneutikës mediatike apo optikës individuale me të cilin vështrohet informacioni që përcillet.

Të gjitha këto realitete të interferuara midis shoqërisë, individit dhe teknologjisë duhen parë me një “optikë” të re, sepse sikurse mendojnë sociologët jetojmë në kohën kur, “Shoqërinë informative e lëvizin informacionet, jo vlerat materiale. Zhvillimi kuptohet përtej rritjes materiale, sepse kërkon ndryshim qëndrimesh, përshtatje kulturore, një arsimim të ri të fuqisë punëtore dhe një strukturë të ndryshuar politike. Me fjalë të tjera, kujdesi për cilësinë e jetës zëvendëson prirjen e njëanshme për qëllime ekonomike”.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

‘Dardanët’ mbajtën stërvitjen e fundit në Kosovë, Muriqi dhe Berisha paralajmërojnë fitore

**EPOKA E RE****Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll të hënën e ka zhvilluar stërvitjen e fundit në Kosovë para ndeshjes miqësore me Norvegjinë e cila zhvillohet të mërkurën në Oslo.

Elbasan Rashani ka stërvitur i ndarë nga grupi, kurse futbollistët e tjerë ishin nën urdhrat e përzgjedhësit Franco Foda. Strategu gjerman u ka kushtuar vëmendje skemave të ndryshme që t'i kundërvihet suksesshëm Norvegjisë. Sulmuesi kryesor i “dardanëve”, Vedat Muriqi, ka paralajmëruar fitore edhe pse është vetëm një ndeshje miqësore ndaj norvegjezëve. “Jemi më të fortë kolektivisht, derisa në aspektin individual duhet të jemi të sinqertë sepse nuk mund të krahasohemi. Besoj që në stadium do të jetë një numër i madh i kosovarëve që jetojnë në Norvegji. Atje është edhe familja e Valon Berishës dhe të gjithë janë të mirëseardhur. Edhe pse është vetëm miqësore ne shkojmë për fitore”, ka thënë Muriqi, i cili ka

folur edhe për lojtarin kryesor të norvegjezëve, Erling Haaland, për të cilin mendon se nuk do ta ketë të lehtë ndaj kapitenit të Kosovës, Amir Rrahmani. “Ata kanë lojtarë superyje botërore, por nëse bazohemi te Haalandi, edhe ne e kemi kapitenin tonë që e ka fituar Serinë A, ka luajtur në Ligën e Kampioneve, kështu që nuk besoj se Haaland do ta ketë të lehtë kundër nesh dhe sidomos Amirit”, ka shtuar Rrahmani.

Për ndeshjen miqësore që Kosova e zhvillon ndaj Norvegjisë ka folur edhe mesfushori me përvojë të madhe, Valon Berisha. Për mesfushorin në fjalë ndeshja ndaj Norvegjisë do të jetë speciale për faktin se në këtë vend mori hapat e parë në futboll, por edhe se familja e tij jeton në këtë shtet. “Po, jemi të gatshëm. Kemi pasur disa ditë të forta të stërvitjeve, sot ka qenë më shumë seancë taktike. Trajneri na ka organizuar mirë dhe jemi përgatitur mirë. Ushtrimet kanë qenë intensive, pasi kemi pasur nevojë, sepse disa lojtarë kanë pasur pauzë 10 ditore para se të grumbullohemi

këtu. Është një ndeshje e veçantë, sepse familja ime jeton atje. Atje jam rritur dhe i kam marrë hapat e parë në futboll. Ata më kanë vlerësuar shumë dhe më kanë dhënë shumë besim kur kam qenë i ri. Kam debutuar për Norvegjinë shumë herët. Sigurisht se do të jetë një ndjenjë e përzier, por gjithmonë e kam ndier veten shqiptar dhe e kam kënaqësinë dhe privilegjin të luaj për Kombëtaren e Kosovës”, ka thënë Berisha. “Por, normalisht se është një ndeshje e veçantë sepse njoh shumë lojtarë, por edhe pjesëtarë të stafit që ende punojnë aty e që kanë qenë në kohën time dhe padyshim do të jetë një ndeshje më e veçantë se të tjerat. Ka shumë shqiptarë në Norvegji, sidomos në pjesën e Oslos, kështu që besoj se do të ketë shumë tifozë shqiptarë që do të na ndjekin nga afër dhe do të na japin energji shtesë për të bërë paraqitje sa më të mirë”, ka shtuar Berisha.

Kosova sot (e martë) e zhvillon stërvitjen e fundit para miqësorës me Norvegjinë në “Ullevaal Stadion”.

SHKURT

Gjilani konfirmon largimin e trajnerit Mezani

Sport Club Gjilani ka njoftuar se marrëveshja e bashkëpunimit me Gentjan Mezanin si shef i shtabit teknik ka përfunduar. Gjilani ka ndërprerë bashkëpunimin edhe me anëtarët e tjerë të stafit teknik, Enver Sermaxhajn dhe Leutrim Arifin. “Vlerësojmë lart gatishmërinë në radhë të parë dhe më pas gjithë kontributin e trajnerit Mezani të dhënë gjatë edicionit 2023/24. Po ashtu, komunikojmë përfundimin e bashkëpunimit edhe me anëtarët e tjerë të stafit teknik, Enver Sermaxhajn, instruktorin e portierëve, si dhe Leutrim Arifin, asistent. Njëherësh u urojmë shumë fat dhe suksese në karrierën e tyre sportive, duke ua rikujtuar që dyert e klubit do të mbeten gjithmonë të hapura për ta”, thuhet në njoftimin e Gjilanit.

Beshiktashi interesohet për Dakun

Sulmuesi Mirlind Daku po shkëlqen në Rusi me skuadrën e Rubin Kazanit. Kjo ka bërë që klubet evropiane t’ia vënë syrin sulmuesit të Kombëtares së Shqipërisë. Mediumi “Takvim” raporton se Beshiktashi ia ka vënë syrin sulmuesit të rrezikshëm, për të cilin ka bërë edhe një ofertë zyrtare. Klubi turk e dëshiron Dakun në vend të Vincent Aboubakar, derisa ende nuk ka arritur marrëveshje për kontratën e re me Cenk Tosun. Vlera aktuale e Dakut është 1,5 milion euro, ndërsa ai i ka zhvilluar 232 ndeshje në karrierë duke kontribuar në 130 gola, përfshirë këtu 109 gola dhe 21 asistime.

UEFA e zbulon ekipin e vitit në Ligën e Kampioneve

UEFA e ka zbuluar ekipin e vitit të Ligës së Kampioneve. Pak ditë më parë u kompletua sezoni 2023/24 i Ligës së Kampioneve, me Realin që e fitoi finalen e madhe me Borussia Dortmundin, ndërsa tash është koha për t’i bërë llogaritë. Shtëpia e futbollit evropian e zbuloi sot skuadrën ideale, ku përfshihen kryesisht lojtarë të finalistëve, me Realin e Dortmundin me nga katër lojtarë. Ndërkaq, nga një lojtar në ekip i kanë edhe Manchester City, Bayern Munchen dhe Paris Saint-Germaini. Lojtari më i mirë i sezonit në Ligën e Kampioneve u zgjodh Vinicius Junior, kurse lojtari më i mirë i ri i sezonit në këtë kompeticion: Jude Bellingham. Formacioni: Kobel, Carvajal, Rudiger, Hummels, Maatsen, Vitinha, Sabitzer, Bellingham, Foden, Kane, Vinicius JR.

Lista e ‘Dardanëve’ U19 për ndeshjet miqësore kundër Shqipërisë

Prishtinë, 3 qershor - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës U19, Adil Maliqi, ka publikuar listën e “Dardanëve” të cilët janë përzgjedhur për ndeshjet e radhës në kuadër të ndeshjeve miqësore kundër Shqipërisë. Ndeshja e parë do të zhvillohet më 6 qershor në orën 18:00, ku Kosova do të

përballet me Shqipërinë, në një sfidë që pritet të jetë emocionuese dhe konkurruese. Ndeshja e dytë do të luhet më 8 qershor në orën 10:00. Të dyja ndeshjet zhvillohen në stadiumin “Egnatia Arena” në Rogozhinë.

Lista e futbollistëve: Miran Qela, Valon Islami, Leon Krasniqi, Dejvid Kabashi,

Nuredin Rexhepi, Leon Parduzi, Luan Lleshi, Erion Rexhepi, Lis Berisha, Jerin Hadergjonaj, Endi Halili, Elvaris Suplja, Leart Hoti, Amar Demolli, Planet Veseli, Dior Gerbovc, Elmor Selishta, Abaz Mazrekaj, Altin Lajqi, Medin Gashi, Leart Binaku, Drin Olluri, Albert Rrahmani.



Wolff: Hamiltoni mund ta fitojë titullin e tetë me Ferrarin

STUTTGART, 3 QERSHOR - Piloti britanik Lewis Hamilton do të garojë me Ferrarin vitin tjetër në Formula 1, duke e braktisur makinën Mercedes, me të cilën bëri historinë. Drejtori sportiv i Mercedesit, Toto Wolff, nuk është aspak xheloz për këtë lëvizje, madje ai beson se shtatë herë kampioni i botës mund të

shpallet kampion me “kokëkuqen”. “Nëse Ferrari mund t’i japë Lewisit një makinë konkurruese, ai mund të fitojë një kampionat botëror, nuk kam asnjë dyshim për këtë. Madje ai mund ta mposhtë Leclercin, pasi ka më shumë përvojë, grintë dhe di si t’i menaxhojë momentet

vendimtare të një sezoni”, u shpreh Toto Wolff. “Unë gjithmonë do të kem një marrëdhënie personale me Lewisin dhe do të shikoj prapa në momentet e shkëlqyera, profesionale dhe personale. Kur Lewisi të transferohet te Ferrari, ai do të bëhet kundërshtar, por unë do t’i uroj gjithmonë ditë të

lumtura. Fillimisht ai më tha se do të qëndronte, më pas vendosi të shkonte. Por njerëzit ndryshojnë mendje dhe, gjithashtu, rrethanat ndryshojnë. Opinione duhet të respektohen dhe unë nuk kam asnjë inat ndaj tij, përkundrazi, i uroj më të mirën”, ka deklaruar Wolff.



Kush është piloti më i pasur në historinë e Formula 1?

Berlin, 3 qershor - Formula 1 ishte dhe është sporti i milionerëve, por kush janë njerëzit më të pasur të gjitha kohëve? Irlandezi Verior Eddie Irvine lulëzoi në fund të viteve '90 kryesisht si shoku i skuadrës së Michael Schumacherit në Ferrari. Pas dëmtimit të Sumit në Silverstone 1999, Eddy e gjeti veten duke sfiduar Hakkinen për kampionatin.

9. Mario Andretti: 127 milionë dollarë

Mario Andretti është padyshim një nga legjendat më të mëdha në historinë e motorsportit. Ai ka fituar kampionate në F1 dhe IndyCar si dhe garat ikonike në Indy dhe Daytona. Dhe i gjithë ky sukses erdhi me tarifat përkatëse. Pas tërheqjes së tij nga veprimi aktiv, Andretti krijoi ekipin e tij. Sot ai ka më shumë një rol këshillues atje dhe drejtohet nga djali i tij.

8. Sebastian Vettel: 137 milionë dollarë

Katër herë kampioni botëror Vettel mund të mos ketë qenë kurrë në qendër të vëmendjes jashtë garave. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se Seb nuk u sigurua që ai të paguhej shumë për shërbimet e tij. Kontrata e tij e fundit me Red Bullin si dhe ato me Ferrari-Aston Martin e vendosin atë lehtësisht në listë. Seb, gjithashtu, ka një koleksion të madh të makinave dhe veturave historike të F1.

7. Jenson Button: 146.6 milionë dollarë

Jenson ishte një nga pilotët më të paguar para vitit 2009, kur fitoi kampionatin e tij të vetëm. Kontrata e madhe që ai mori nga McLaren pas kësaj vetëm... e fryu më tej llogarinë e tij bankare. Button nuk është plotësisht jashtë F1, pavarësisht se ka 7 vjet që nuk ka luajtur. Ai është komentues mjaft i shpeshtë në televizionet britanike dhe ka një pozicion këshillues me ekipin me të cilin debutoi Williamsi.



6. Kimi Raikkonen: 178.4 milionë dollarë

Kimi i ka investuar paratë që ka fituar nga F1 në prona të paluajtshme në Finlandë dhe jashtë saj. Ai, gjithashtu, mbështet hapat e parë të djalit të tij Robin në motorsport.

5. Niki Lauda: 195.5 milionë dollarë

Për të madhin Niki Lauda, pjesa financiare e pjesëmarrjes së tij në F1 ka qenë gjithmonë e rëndësishme. Austriaku edhe pse vinte nga një familje e pasur, nuk kishte mbështetje për ëndrën e tij. Para se të merrte kontratën e tij të parë të madhe, Lauda kishte lënë peng gjithçka duke vënë bast për veten e tij. Por Nicky fitoi bastin e madh të jetës. Dhe që kur shkoi te Ferrari, gjendja e tij financiare është përmirësuar çdo vit. Më vonë ai themeloi linjën e tij ajrore.

4. Max Verstappen: 210 milionë dollarë

Marrëveshja e madhe e Maxit me Red Bullin më 2022 e ka bërë atë pilotin më të paguar në rrjetin aktual. Dhe sigurisht kjo e vendosi atë në listën E më të paguar të të gjitha kohëve. Jo pa të drejtë. Max është padyshim piloti më i mirë në F1 dhe është në periudhën më të pjekur të karrierës së tij. Nuk do të ishte çudi ta shihnim holandezin në krye të një liste të tillë në të ardhmen.

3. Fernando Alonso: 260 milionë dollarë

Nando mund të mos ketë fituar aq kampionate sa e meritonte talenti i

tij rrallë. Megjithatë, ai me siguri e fitoi të drejtën e tij nga karriera e tij e gjatë në këtë sport. Spanjoli ndonjëherë ka udhëhequr përpjekjet në Renault, McLaren dhe Ferrari. Sigurisht, me kompensim. Sot ai kandidon për Aston Martin. Dhe performanca e tij në pistë tregon se Alonso mund të vazhdojë ta bëjë këtë edhe për një kohë të gjatë!

2. Lewis Hamilton: 285 milionë dollarë

Shtatë herë kampioni i botës ka thyer rekordet më të shumta në F1. Dhe sigurisht ai është shumë lart në listën e shoferëve më të paguar. Lëvizja e tij te Mercedesi në vitin 2013 doli të ishte e artë. Jo vetëm konkurrues, por edhe financiar. Ai ishte prej vitesh piloti më i paguar në kampionat. Kontrata që ka siguruar me Ferrarin është gjithashtu shumë e lartë. Dhe Lewis po sigurohet vazhdimisht që t’o investojë fitimet e tij si dhe të japë për bamirësi.

1. Michael Schumacher: 586.5 milionë dollarë

Sigurisht, në disa fusha i madhi Michael Schumacher do të mbetet i patejkalueshëm. Në vitet 1999 dhe 2000 revista “Forbes” e vendosi atë në krye të listës së sportistëve më të paguar në botë! Fatkeqësisht, jeta e Schumacherit ndryshoi tërësisht pas aksidentit që pati në resortin dimëror të Mirabelit në vitin 2013. Megjithatë, edhe kështu ai mbetet gjithmonë në zemrat e të gjithë adhuruesve të vërtetë të autosportit.

SHKURT

Hysaj, afër divorcit me Lazion

Mediet italiane shprehen të sigurt se Elseid Hysaj do të largohet nga Lazio në verë. Anëtori kuqezi nuk bën më pjesë në planet e klubit, me Lazion që po punon për të gjetur një anësor të ri. Objektivi i saj kryesor është Patrick Dorgu i Lecces.

Në fakt, që pas largimit të Sarrit, Hysaj shihej nga mediet si i sakrifikuari i parë. Për momentin nuk është e qartë se ku pritet ta vijojë karrierën. Diskutimi mbi të ardhmen e tij pritet të spostohet pas “Euro 2024”, ashtu si për të gjithë legjionarët kuqezi që do të jenë në qendër të vëmendjes.

Barça, PSG-ja dhe Unitedi, në garë për De Ligtin

Mbrojtësi holandez Matthijs de Ligt ka pasur një sezon me ulje dhe ngritje, por kjo nuk i ka penguar tri klube të mëdha evropiane që të hyjnë në garë për transferimin e tij. Barcelona, Paris Saint Germaini dhe Manchester Unitedi kanë shprehur interesim për ish-mbrojtësin e Juventusit dhe Ajaxit, derisa e përditshmja franceze “L’Equipe” raporton se e ardhmja e lojtarit do të vendoset pas Kampionatit Evropian kur ai do të bisedojë me trajnerin e ri të Bayernit, Vincent Kompany. Bayerni ka paguar 67 milionë euro për transferimin e tij dy vjet më parë, derisa tani është i gatshëm të lejojë të largohet nëse vjen një ofertë rreth 55 milionë euro.

Perez: U përpoqa ta rinovoja kontratën me Kroosin, por gjermanët duan të largohen si legjenda

Presidenti i Realit të Madridit, Florentino Perez, ka konfirmuar tentativën e fundit të dështuar apo përpjekjen për ta bindur gjermanin Toni Kroos ta shtynte lamtumirën e tij nga Spanja dhe futbolli (pas Kampionatit Evropian) dhe në vend të kësaj të nënshkruante një rinovim të kontratës. Vullneti i lojtarit ishte i qartë. Mesfushori gjerman nuk donte t’ia dinte, ishte i vendosur për t’u larguar nga Madridi, duke mohuar çdo përvojë diku tjetër. “Ne i ofruam atij rinovimin e kontratës, por është e qartë se dëshironte të tërhiqej në kulmin e tij”, ka thënë presidenti i Realit pas suksesit në finalen e Ligës së Kampionëve, kundër Borussia Dortmundit, në “Wembley”. “Ju e dini se si janë gjermanët. Është shumë e vështirë t’i bësh të ndryshojnë mendje. Ai bëri atë që donte të bënte, largohet si legjendë dhe ne do ta kujtojmë gjithmonë si një nga më të mëdhenjtë në botë”, ka thënë Perezi. Për Toni Kroosin nuk ka kthim pas: Kampionati Evropian në shtëpi do të jetë “vallëzimi i fundit” për të, më pas “do t’i varë këpucët në gozhdë”.

Modriqi konfirmon qëndrimin te Reali

Luka Modriqi ende nuk ka nënshkruar kontratë të re me klubin dhe e ardhmja e tij ende nuk është vendosur. Megjithatë, duke folur në festën e triumfit në Ligën e Kampionëve në “Bernabeu”, kroati është shfaqur duke konfirmuar se do të

qëndrojë në Real Madrid edhe një tjetër sezon. “Shihemi sezonin e ardhshëm”, ka thënë fillimisht mesfushori legjendar i “Los Blancos”. “Është hera e gjashtë këtu. Ky sezon ka qenë i bukur. Jemi shumë të lumtur që jemi në ‘Bernabeu’ duke festuar. Dua t’i

falënderoj tifozët tanë për mbështetjen e tyre. Ata janë shumë të rëndësishëm për ne. Ata ndoshta as nuk e dinë se sa të rëndësishëm janë. Tifozët na shtyjnë gjithmonë. Ne i duam. Kemi pasur shumë probleme këtë sezon për shkak të lëndimeve dhe

e kemi ndihmuar njëri-tjetrin si një familje. Kjo është mënyra e vetme për të fituar tituj. Ne kemi qenë një familje këtë sezon”, ka shtuar Modriqi. “Të fitojë të titullin e shtatë të Ligës së Kampionëve sezonin e ardhshëm? Natyrisht, ne do të

kemi shumë tituj për të luajtur vitin e ardhshëm”, ka deklaruar Modriqi. Edhe presidenti i Real Madridit, Florentino Perez, ka konfirmuar se marrëveshja me Modriqin do të zgjatet dhe se kroati do ta vijojë karrierën në “Santiago Bernabeu”.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"
Fakulteti Juridik

Rr. Agim Ramadani, nr. 14, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381-38-229063

URL: <http://www.uni-pr.edu>

Në bazë të nenit 127 al.1 të statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", neni 17 al. 2 dhe 4, të rregullores mbi studimet shkencore pasdiplomike dhe vendimit nr.. 9/21 nga Mbledhja e Këshillit të Fakultetit Juridik, të datës 12.03.2024, si dhe vendimit për ratifikimin nga Senati i UP, nr. 1/472, datë 14.05. 2024, kandidatit **Ma.sc. Nur Çeku, PhD. cand,** i është lejuar mbrojtja publike e disertacionit të doktoratës, andaj mbi bazën e dispozitave të më lartë cekura bëjmë këtë

NJOFTIM

Me të cilin njoftojmë të gjithë të interesuarit, se me datën 14.06.2024, me fillim në ora 14:00, në sallë të mbledhjeve të Fakultetit Juridik të UP-së, kandidati për fitim të titullit doktor i shkencave juridike-nga fusha kushtetuese- administrative , **Ma.sc. Nur Çeku** e bënë mbrojtjen publike të disertacionit me titull: **"Efekti i mbikëqyrjes parlamentare në llogaridhënien dhe sundimin e ligjit në Kosovë"**, para komisionit profesional në përbërje:

1. Prof. Dr. Visar Morina, (Kryetar) Fakulteti Juridik,
2. Prof. Asoc. Dr. Gjyljeta Mushkolaj (Anëtar) Fakulteti Juridik,
3. Prof. Dr. Bedri Peci (Anëtar) Fakulteti Juridik,
4. Prof.Asoc. Dr. Murat Jashari (Anëtar) Fakulteti Juridik,
5. Prof. Asoc. Dr. Blerton Sinani(Anëtar i jashtëm)- Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Evropës Juglindore.

Mentor i kandidatit:
Prof. Dr. Arsim Bajrami

Prishtinë
31.05.2024

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Edona Shala shpall te pavlefshme diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Bislim Maloku shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Velezerit Frasheri" Planej.

- Zehajdin Bilibani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Leke Dukagjini" Prizren.

- Azar Zyrali shpall te pavlefshme certifikatën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Valdrin Bellanica nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Lis Zhaveli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lendita Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e sh.f.m.u. "Mazllom Këpuska" Gjakovë. Nga kl. 1-8.

- Ethem Bokshi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

Lume's Details

Estetik & Depilim



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1909

Columbus, Georgia, USA
0.5L

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

